



KËSHILLI KOORDINUES I DIASPORËS

22 Prill 2021

Prononcim

Si institucion që ka për detyrë të përfaqësoj interesat e Diasporës, që në fillim të ngritjes së tij kemi qenë të angazhuar për realizimin e votimit të shtetasve shqiptarë me banim jashtë Republikës së Shqipërisë. Deri në Mars 2021 kemi qenë pjesë e konsultimeve me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve (“KQZ”) si grup interesi, së bashku me grupe tjera interesi, ku përmes konsultimeve dhe shkëmbimeve të ideve kemi kontribuar në përgatitjen e akteve nënligjore për mundësimin e votimit nga jashtë në zgjedhjet e 25 Prillit 2021.

Pavarësisht këtij angazhimi më datë 29 Mars 2021 KQZ na informoi se votimi për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë Shqipërisë për zgjedhjet e 25 Prillit nuk do të jetë i mundur nga vendet ku ata jetojnë meqë aktet e nevojshme nënligjore nuk janë miratuar.

Si institucion shprehim shqetësimin tonë që votimi nga jashtë për zgjedhjet e 25 Prillit nuk u mundësua. Përrjashtimi nga procesi i votimit i një grupi të madh votuesish nga diaspora është një shkelje serioze e kushtetutës, e kodit zgjedhor dhe të drejtave të njeriut dhe vë në dyshim legjitimitetin e procesit të votimit.

Mosrealizimi i këtij procesi nënkupton që e vetmja mënyrë e shtetasve që banojnë jashtë territorit të vendit të ushtrojnë të drejtën e votës është përmes udhëtimit drejt Shqipërisë. Një akt i tillë është sa patriotik aq dhe me pasoja të shëndetit publik në kushtet e pandemisë, ku votuesit rrezikojnë të infektojnë veten, të afërmit e tyre dhe të tjerët.

Mungesa e vullnetit politik dhe mospajtimet mes liderëve të politikës Shqiptare rreth mundësimit të votimit nga jashtë e kanë dëmtuar rëndë besimin e ndërsjellë mes Diasporës Shqiptare dhe të institucioneve shtetërore e politike përfshirë edhe të gjitha partitë politike pa përjashtim.

KQZ na ka informuar se do të vazhdoj angazhimin që votimi nga jashtë të mundësohet pas zgjedhjeve të 25 Prillit. Mirëpresim këtë angazhim të KQZ-së dhe kërkojmë që kuadri i nevojshëm ligjor të miratohet sa më shpejt dhe që KQZ të adoptoj metodat më të avancuara dhe më efikase të votimit nga jashtë.

Si institucion do të vazhdojmë të jemi të angazhuar maksimalisht si grup interesi në konsultimet me KQZ-në si dhe do të ndjekim të gjitha rrugët ligjore deri sa votimi i diasporës nga jashtë të bëhet realitet.

U bëjmë thirrje të gjithë shtetasve shqiptarë në territorin e Shqipërisë si dhe atyre që gjinden jashtë vendit të cilët e kanë mundësinë të udhëtojnë për në Shqipëri që të marrin pjesë në votim në zgjedhjet e 25 Prillit.

Kontakti:

info@keshillikoordinuesidiaspores.com

www.keshillikoordinuesidiaspores.com